



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar sipas Ligjit Nr. 05/L-150 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10 / 03 prill 2017), nenin 4, paragrafi 3, dhe nenin 72 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR AKTUARËT E SIGURIMEVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të plotësojë, ndryshojë dhe harmonizojë Rregulloren për Aktuarët e Sigurimeve (rregullorja bazë), e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më datë 31 mars 2016.

Neni 2

Në nenin 14 të rregullores bazë, shtohet paragrafi 7 me përmbajtjen si në vijim: 7. Një aktuar nuk mund të jetë i angazhuar për të kryer veprime aktuariale të më shumë se dy sigurues njëkohësisht.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më datë 1 janar 2025.

Bashkim Nurboja

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës